



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2994/7 prot

Datë 14.11.2025

V E N D I M
Nr. 1682/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.11.2025, me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gjergj Buça” PF, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-62380-09- 23-2025, me objekt: “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirdite”, me fond limit 2,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 13-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirdite.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “XHEKSONI-04” SHPK, me NIPT K39010090G dhe adresë: Lagjja Nokaj , banesë private 2-katëshe nr.4, kati parë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Mirdite, me adresë: Sheshi “Abat Doçi”, 4601 Rrëshen.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “GJERGJ BUÇA” PF, me NIPT K31331547R dhe adresë: Lagja nr.14, Ura Dajlanit.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, por nuk ka plotësuar kushtet formale konkretisht një nga elementet e cituara në ligj sic është mandati pagesa e cila nuk është paraqitur.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24-09-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-62380-09- 23-2025, me objekt: “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirdite”, me fond limit 2,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 13-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirdite.

II.2. Në datën 13-10-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti

kontraktor në datën 15.10.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|----------------------------------|-------------------------------|
| 1. “Gjergj Buca” P.F, me vlerë: | 2,227,500.00 lekë kualifikuar |
| 2. “XHEKSONI-04” SHPK, me vlerë: | 2,470,500.00 lekë kualifikuar |

II.4. Në datën 20.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datë 22.10.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5999, dhe me nr. protokoli 2994/2025 datë 23.10.2024 e operatorit ekonomik “XHEKSONI-04” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-62380-09-23-2025, me objekt: “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirdite”, me fond limit 2,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 13-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirdite.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2994/4 prot., datë 10.11.2025.

II.7. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2994/1 prot., datë 28.10.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “XHEKSONI-04” SHPK.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.3197/11 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2994/2 prot., datë 31.10.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “XHEKSONI-04” SHPK.Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik “XHEKSONI-04” SHPK, ankimues dhe ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.9. Më datë 06.11.2025, operatori ekonomik “Gjergj Buca” PF ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumentave, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 2994/3 prot., datë 06.11.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ankimues “XHEKSONI-04” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “GJERGJ BUÇA” PF në procedurën e mësipërme të prokurimit me arsyen se: *“Në praktikën e APP dhe të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP): kërkesa për të pasur një numër punonjësish të siguruar duhet të bazohet në periudhë referimi të mëparshme (zakonisht 3-6 muaj përpara shpalljes së tenderit, sipas bilanceve dhe sigurimeve në e-Albania/ISSH). Nuk mund të kërkohej që punonjësit të jenë të siguruar pikërisht në muajin e shpalljes së tenderit, sepse ky është një kriter retroaktiv dhe diskriminues. 3. Minimumi i periudhës së sigurimit Institucionet kërkojnë deklaratë nga ISSH për punonjësit e siguruar në 3 muajt e fundit; Referuar paraqitjes së ofertës por fatkeqesisht dhe publikimit nga ana e Autoritetit kontraktor Bashkia Mirdite, numri prej 8 punonjësve të siguruar nga ana e operatorit ekonomik “gjergj buca” ka datë fillimi muajin shtator, kur edhe njoftimi është bërë me 23 shtator sipas reference: REF-62380-09-23-2025”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, pika 2.3.4 e “KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” është parashikuar si më poshtë vijon:

[...]

“2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm për 8 (tetë) punonjës të siguruar për muajin shtator 2025 e në vazhdim për zbatimin e kontratës. **Shënim** (8 punonjës gjithsej, përfshirë dhe punonjësin me deshmë kualifikim të përmendur në pikën 2.3.3)

- a) Kjo të deshmohet me vertetim të leshuar nga Administrata Tatimore për numrin e punonjësve të siguruar (**Formulari E-SIG 02/a**) të shoqërohet me formularët E-SIG 025/a.”

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.3. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III. 1.4 Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi

të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.5. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*.

III.1.6. Komisioni i prokurimit publik konstaton se, referuar pretendimit si dhe gjithashtu dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik nga operatori ekonomik “Gjergj Buça” PF rezulton se, operatori ekonomik ka ngarkuar në sistemin elektronik dokumentacionin me të dhëna si më poshtë:

-Listepagesa_09_2025, “DEKLARATA "Listepagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi", Muaji: Shtator, Periudha Tatimore Viti: 2025, në të cilin konstatohen të deklaruar 8 persona punonjës.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për përzgjedhjen e fituesit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave. Vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, *Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm për 8 (tetë) punonjës të siguruar për muajin shtator 2025 e në vazhdim për zbatimin e kontratës. Shënim (8 punonjës gjithsej, përfshirë*

dhe punonjesin me deshmi kualifikim te permendur ne piken 2.3.3), a)Kjo te deshmohet me vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar (Formulari E-SIG 02/a) te shoqerohet me formularet E-SIG 025/a, operatori ekonomik ka dorëzuar deklaratat si më sipër cituar në pikën III.1.7 të këtij vendimi mbi këtë kërkesë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton se operatori ekonomik “Gjergj Buça” PF me dorëzimin e dokumentit “DEKLARATA "Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi" vulosur elektronikisht nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, referuar kriterit në pikën 2.3.4, rezultjnë të deklaruar 8 punonjës për përiushën tatimore Shtator 2025. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “GJERGJ BUÇA” PF në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për përzgjedhjen e fituesit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave. KPP vlerëson se në respekt të parimit të proporcionalitetit për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional, operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave me anë të dokumentacionit konkret të lëshuar nga organet kompetente të provojnë, se disponojnë një numër të caktuar të punonjësve dhe gjithashtu punonjësit aktualë të jenë të siguruar, por jo të kushtëzojë operatorët ekonomikë që të vërtetojnë se disponojnë një numër të tillë punonjësish për periudhën 3 muajve të fundit. KPP gjykon, se operatori ekonomik ka arritur të provojë këtë kërkesë me anë të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin elektronik të pasqyruar dhe me lart këto të fundit.

Komisioni gjykon se referuar konstatimeve të mësipërme pretendimi i operatorit ekonomik “XHEKSONI-04” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “XHEKSONI-04” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-62380-09- 23-2025, me objekt: “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirdite”, me fond limit 2,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 13-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirdite.
 2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

